




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 789/5 prot.

Tepelenë, më 04, 05, 2026

V E N D I M

Nr. 37..., datë 29.4.2026

**“PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË
TEPELENËS”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35 datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 776, datë 19.12.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, si dhe në vijim të relacionit të grupit të punës nr.789 prot., datë.23.04.2026,, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave të Njësive Administrative të Bashkisë së Tepelenës sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Miratimin e shpërblimit mujor të 24 kryetarëve të fshatrave në masën 5% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 janar të vitit 2026 dhe do të përballohen nga të ardhurat e Aparatit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2026.

4. Vendimi nr. 86, datë 30.11.2023 i ndryshuar me Vendimin nr 55, datë 30.09.2024 , i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tepelenës”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Drejtoria e Ligjore dhe Shërbimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e Menaxhimit Financiar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR
Arben Gumeni

Lidhja Nr. 1 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5 001 - 20 000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
1	—	Administrator	—	120,000
2	IV-3	Specialist	1/2/3	60,000
3	IV-4	Specialist	1/2/3	55,000

Lidhja Nr. 2 – Niveli i pagave në Njësitë Administrative me më pak se 5 000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
1	—	Administrator	—	90,000
2	IV-4	Specialist	1/2/3	55,000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 1, për specialistët llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:
- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ të Njësive Administrative

Nr	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi
1	Pika 11	Punonjës administrative	57,000	1%
2		Punëtor Shërbimi, Mirëmbajtës	50,000	1%
3		Pastrues, Roje	52,000	1%

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr.3 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona Çela

Miratuar me 11 vota

Vota Pro 11

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0 Zbardhur me datë 04.05.2016